



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VIII-të për vitin 2013, e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 25.07.2013

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Abdullah Vojvoda, Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nasuf Aliu, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Veli Karaça, Xhemajl Pllana dhe Zeqir Hasani.

Munguan: Syzana Sylja, Vlora Qirezi, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Në fillim të hapjes së mbledhjes së KK-së, e dhanë betimin dy anëtarët e rinj të KK-së: Abdullah Vojvoda dhe Nasuf Aliu.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- propozoi që rendit të ditës t'i shtohen në "të ndryshme": kërkesa e banorëve të banesës përballë kalasë dhe propozimet për dy anëtarët e rinj të KPF-së.

Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit- lidhur me ish anëtarin e KK-së Tasim Gubetini, tha se personit në fjalë iu është bërë e padrejtë, meqë nuk është mbrojtur fare nga komuna, pasi që në bazë të atij udhëzimi janë shumë anëtarë të KK-së që marrin dy paga nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të LDK-së tha se mendon sikur anëtar i KK-së I.Krasniqi, sepse iu është bërë e padrejtë dhe komuna duhet të veprojë njësoj për të gjithë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se e vlerëson lartë kontributin e dhënë nga Tasim Gubetini dhe i njëjti e ka respektuar ligjin, si dhe ka respektuar vendimin e një institucioni i cili ka kërkuar nga ai që të japë dorëheqje, kurse organet e komunës nuk janë kompetente për të vendosur për atë që tha shefi i Grupit kuvendar

i LDK-së dhe shtoi se në çdo anëtar i KK-së duhet ta respektojë ligjin dhe në bazë të ligjit duhet të japin dorëheqje, pasi që nuk është vetëm rasti i Tasim Gubetinit, por janë edhe shumë të tjerë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me rastin e Tasim Gubetinit, tha se pajtohet me qëndrimin që nëse jemi parimor, duhet të jemi parimor për të gjithë, sepse nëse ish-anëtar i KK-së në fjalë punon në një bankë private, ai shumë më pak ka pas të drejtën e tërheqjes, përderisa në mesin tonë ka forma të tjera të veprimit. Pastaj tha se në mbledhjen e kaluar të KK-së u pajtuam që në rend dite të jetë çështja e përgjithshme e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, pasi që me Planin vjetor të punës së kuvendit kjo temë është paraparë në fundin e muajit tetor, por fundi i tetorit është në pikëpyetje se a mbahet mbledhja e KK-së, pasi që janë zgjedhjet lokale, prandaj në emër të Grupit kuvendar të AAK-së kërkoi që kjo temë të hyn në fundin e muajit shtator. Po ashtu propozoi që në "të ndryshme" të trajtohet shqetësimi i banorëve rreth lumit "Podrança" lidhur me depërtimin e zvarranikëve të shumtë nëpër shtëpi dhe kjo vjen si rezultat i mospastrimit të barit dhe barojave, si dhe prezencës së ujërave të zeza në atë prroskë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- lidhur me punimet që janë duke u zhvilluar në rr. "Dëshmorët e Kombit" (në segmentin tek kalaja e qytetit), paraqiti shumë pakënaqësi të qytetarëve se ritmi i punimeve në këtë segment nuk është ai që duhet të jetë, dhe shtoi se kudo në vendet që punohet mirë, në rastet kur kryhen punime në të tilla rrugë, punohet përtej orarit me ritëm të shpejtë, në mënyrë që vështirësitë e qytetarëve të jenë sa më të pakta dhe në afat sa më të shkurtër, por fatkeqësisht kjo nuk po ndodh në rr. "Dëshmorët e Kombit", pasi që ka raste kur dita është e mirë dhe nuk vazhdoen punimet. Po ashtu tha se kudo ku punohet mirë, shënohet koha e fillimit të punimeve dhe koha e përfundimit të punimeve, por në këtë segment nuk ekziston një shënim (informim) i tillë, po ashtu shqetësuese është që në këtë kohë kanë ardhur shumë bashkatdhetarë, prandaj ky ritëm i ngadaltë i punimeve në këtë segment është një mosrespekt ndaj tyre. Në vazhdim tha se në rr. "Pandeli Sotiri" janë të vendosura disa lokale, ku frekuentojnë një numër jashtëzakonisht i madh i të rinjve dhe aty vijnë parkohen pa të drejtë vetura të shumta, kurse policia nuk bashkëpunon me komunën në mënyrë që të menaxhohet mirë ajo situatë për të mos u krijuar probleme dhe rreziqe, prandaj kërkoi nga autoritetet komunale që në bashkëpunim me policinë të menaxhohet më mirë situata, të shtohet ritmi i punimeve, të dihet kur përfundojnë këto punime, sepse edhe shumë biznese që operojnë në këto pjesë të rrugëve kanë pakënaqësi të shumta, pasi që nuk janë të informuar, dhe shtoi se këto veprime të autoriteteve komunale bien ndesh me Rregulloren për Transparencë dhe me Strategjinë për Informim dhe Bashkëpjesëmarrje të Qytetarëve në Vendimmarrje. Në fund ngriti shqetësimin se ka shumë lokale shitëse ku ofrohen mallra, të cilat ekspozohen në trotuare, dhe të njëjtat iu ekspozohen temperaturave të larta, dhe si rezultat i këtij ekspozimi i humbin cilësitë dhe vetitë e tyre dhe paraqesin rrezik shumë serioz për shëndetin e konsumatorëve, prandaj ka kërkuar disa herë nga Drejtoria për Inspektime që të marrë masa, por deri më tani drejtoria në fjalë është treguar e paafte për të sanuar këtë situatë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- paraqiti shqetësimin lidhur me shëndetin e nxënësve në shkollat e Vushtrrisë, pasi që janë me dhjetëra shkolla që janë të mbuluara me lesenit, duke shtuar se leseniti paraqet rrezik permanent për shëndetin e nxënësve, prandaj kërkoi që të debatohet për këtë temë, duke kërkuar që të bëhet një projekt për evitimin e lesenitit nëpër shkollat tona.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- tha se pasi që sot një vit është vlarë heroit Enver Zymberi, është dashtë t'i kushtohen disa minuta figurës së tij, i cili ra heroikisht në mbrojtje të atdheut. Pastaj tha se në bazë të informacioneve nga përgjegjësi i shoqatës "HANDIKOS" e cila ndihmon nevojtarët e komunës sonë, është informuar se kësaj shoqate iu është ndërprerë buxheti, prandaj i propozoi kuvendit të komunës

që tani për tani kësaj shoqate të mos i ndërpritet buxheti, por të gjenden forma që nga komuna të ruhet kontinuiteti i financimit të saj. Në fund lidhur me rendin e ditës, tha se rendi i ditës është shumë i ngarkuar, prandaj propozoi që pika nr. 7 të shtyhet për mbledhjen tjetër të KK-së, pasi që nuk i kalon afati.

Selvete Sholla, anëtare e kuvendit- paraqiti shqetësimin e qytetarëve lidhur me mungesën e ujit, ku në kohët e fundit është jashtë normales, pasi që uji vjen vetëm gjysmë ore në kohë të iftarit dhe shtoi se uji kundërmon myk, prandaj pyeti se a është i pijshëm ky ujë, në mënyrë që të mos vijë deri te përhapja e sëmundjeve të ndryshme.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar vërejtjeve dhe propozimeve të anëtarëve të kuvendit u përgjigj me sa vijon: çështja e dorëheqjes së anëtarëve të kuvendit nuk është kompetencë e komunës, që institucioni i komunës ta trajtojë dorëheqjen e ndonjë anëtari të kuvendit të komunës, duke shtuar se për rastin e Tasim Gubetinit ka dhënë vërejtje Agjencioni Antikorrupsion, prandaj i njëjti është detyruar të japë dorëheqje. Sa i përket informatës për gjendjen e sigurisë, tha se informata në fjalë sipas Planit vjetor të punës së kuvendit është paraparë për muajin tetor, kurse lidhur me prrockën tek lumi "Podrança", sqaroi se në vitin 2008 i është bërë një trajtim prroskës në fjalë dhe prroska të tilla ka pothuajse nëpër tërë komunën tonë, prandaj nëse fillon pastrimi i tyre, paraprakisht duhet bërë planifikimi. Ndërsa për punimet që po zhvillohen në rr. "Dëshmorët e Kombit", tha se shumë infrastrukturë nëntokësore duhet të punohet në këtë rrugë, prandaj nevojitet afat më i gjatë kohor për finalizimin e punimeve. Në vazhdim tha se do të interesohet se cilat shkolla janë të mbuluara me tjegulla nga materiali i asbestit, mirëpo për këtë çështje nevojitet planifikim i mjeteve. Sa i përket 2 vjetorit të rënies së heroit Enver Zymberi, njoftoi se është planifikuar që sot pasdite një delegacion i komunës të marrë pjesë në vënien e kurorave tek varri i heroit. Pastaj tha se shoqata "HANDIKOS" është ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme nga komuna, ku edhe në këtë vit janë planifikuar 3.000 €, duke shtuar se qeveria lokale e ka ndihmuar këtë shoqatë edhe me riparimin e veturave të saj dhe me karburante, por për këtë vit pasi që nuk ka mjete të tjera të planifikuara, mund t'ju ndihmohet nga mallrat dhe shërbimet (me vendim të kryetarit të komunës) për mbulimin e shpenzimeve të karburanteve. Në fund lidhur me furnizimin me ujë të pijshëm, tha se fabrika është projekt trevjeçar dhe pritet që vitin e ardhshëm të ketë ujë të mjaftueshëm.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me 31 vota "për", 2 "abstenim" miratoi këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 11.06.2013;**
- 2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 27.06.2013;**
- 3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndarjen e bursave për studentë (shqyrtimi i dytë);**
- 4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për dhënien e dekoratave (shqyrtimi i dytë);**
- 5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2014 (shqyrtimi i parë);**
- 6. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2013;**
- 7. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2012;**
- 8. Shqyrtimi i Draft-rregullores për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve (shqyrtimi i parë);**

9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me përfundimin e gjysmëvjektorit të dytë në shkollat fillore dhe të mesme në Komunën e Vushtrrisë;
10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen shëndetësore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë;
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme;
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e listës për emërtimin e rrugëve dhe shesheve, si dhe kompensimin e anëtarëve të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
13. Të ndryshme:
 - a. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të banesave përballë kalasë,
 - b. Shqyrtimi i propozimeve për plotësimin e numrit të anëtarëve të KPF-së,
 - c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 11.06.2013.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- në faqen nr. 2 kërkoi që të plotësohet diskutimi i tij ku ka paraqitur dy propozimet për t'ju dhënë përparësi rregullimit të kanalit të kullimit në rrugën e fshatit Maxhunaj, si dhe propozimit që t'i jepet përparësi shtrimit të rrugës në lagjen e "Starasellëve" në fshatin Dumnicë e Llugës. Për këto dy propozime duhet shtuar këto arsyetime: pasi që është një pjesë e rrugës ku fle uji dhe ka pasur aksidente, prandaj propozimin për dhënien përparësi e paraqiti në mënyrë që të shmangen aksidentet dhe të mos rrezikohen kalimtarët, kurse për propozimin tjetër ka paraqitur këtë arsyetim: të realizohet me qëllim të stimulimit të zhvillimit të blegtorisë, sepse ka familje që janë zhvendosur nga qyteti në lagjen në fjalë, të cilët po dëshirojnë ta zhvillojnë blegtorinë.

Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, me vërejtjen e B. Jasharit.

2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 27.06.2013.

Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndarjen e bursave për studentë (shqyrtimi i dytë).

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të LDK-së paraqiti këto vërejtje: në fillim të draftit (te thirrjet në dispozitat ligjore) të shkoqitet emërtimi i rregullores; për nenin 12.7 kërkoi sqarime dhe shtoi se hartuesi me siguri ka menduar që pikën nr. 7 ta bëjë 8, sepse përmbajtja në vazhdim nuk përkon me dispozitat e rregullores; te neni 16 propozoi që komisionin për ndarjen e bursave ta formojë kuvendi i komunës, pasi që është më transparente.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të AAK-së paraqiti këto propozime: te neni 2 propozoi që të futen edhe nxënësit talentë të rrallë të shkollave të mesme të ulëta dhe të shkollave të mesme të larta, pasi që kjo kategori e nxënësve është kapital për komunën, por edhe për Kosovën; edhe te neni 4 propozoi që të shtohet kategoria e "bursave për nxënës talentë"; po ashtu mbështeti propozimin që emërimi i komisionit për ndarje të bursave të jetë kompetencë e kuvendit të komunës.

Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, paraqiti këto sqarime: neni 12 pika 7 ka qenë i ndarë në nënpikat a, b, c, d, prandaj kërkoi që të jetë me këto nënpika; te neni 16, tha se të gjitha komisionet e ekzekutivit që

përfshijnë më shumë se një departament i themelon kryetari i komunës, sepse nuk ka logjikë që të shndërrohet legjislativi në ekzekutiv.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se në mbledhjen e kaluar të KK-së është marrë vendim që të hartohet një draft-rregullore e veçantë për ndarjen e bursave për nxënësit, prandaj kërkoi që të mos futen në këtë nen që nga nxënësit deri te doktorët e shkencave, sepse këto bursa janë vetëm për studime universitare dhe pasuniversitare, prandaj për ndarjen e bursave për nxënësit duhet të hartohet një draft-rregullore e veçantë. Po ashtu tha se edhe herën e kaluar jemi pajtuar që këto bursa t'ju ndahen vetëm studentëve që studiojnë nëpër universitete publike e jo edhe atyre private, sepse nuk kemi obligim për t'i ndarë bursa studentëve të universiteteve private, përderisa ata kanë para që të paguajnë vitet deri në 2.000 € e më tepër.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, kërkoi sqarim për përmbajtjen e nenit 6.2. Pastaj tha se kur po flitet për universitetet private, po krijohet përshtypja sikur nuk po i njohim ato universitete edhe pse ato janë legale dhe të licencuara, prandaj duhet respektuar pasi që janë pjesë e sistemit arsimor të Republikës së Kosovës, dhe shtoi se ka raste që dikush nuk i ka ekonomikisht punët mirë dhe ndonjë i afërm ia ka paguar një pjesë të shkollimit, por nuk i qëndron gjithmonë pranë, megjithatë duhet të merren parasysh këto raste. Kurse lidhur me nenin 12.5, tha se autoritet komunale duhet të kenë konsideratë për fëmijët, sidomos për vajzat që vijnë nga zonat e thella rurale, kështu që është mirë që të trajtohen rastet e tilla, sepse ka edhe raste që mund të jenë dy fëmijë binjakë dhe shumë të aftë, por kushtet ekonomike i kanë shumë të rënda.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- lidhur me nenin 11 të draft-rregulloren në fjalë, tha se bursat për doktoraturë dhe specializime shkojnë me konkurs në nivelin e Universitetit Publik të Prishtinës dhe janë të parapara në një procedurë tjetër ligjore dhe profesionale, prandaj pyeti se a i përgjigjet komunës që komuna të ketë një standard të tillë dhe ta fus në bursa të tilla, kur doktoranti dhe specializanti kanë mundësi të kenë të ardhura materiale për t'i mbuluar shpenzimet e veta, dhe shtoi se në këtë mënyrë po krijohet një konkurrencë jo-lojale dhe jo e pranueshme në rrethana me nxënës dhe studentë.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, te neni 12.2 propozoi që të jetë për 12 muaj, kurse te neni 16 propozoi që të futet edhe një pikë ku komisioni duhet të jetë transparent për punën e tij, duke e informuar kuvendin e komunës për shpalljen e konkursit, me listën e studentëve që kanë konkurruar dhe me emrat e studentëve që kanë përfutur.

Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit- pasi që ka qenë bashkëhartues i draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto sqarime shtesë: nëse hiqen universitetet private, atëherë prishet struktura e draft-rregullores dhe shtoi se në universitetet private nuk shkojnë vetëm studentët që kanë shumë para, por shkojnë edhe studentët që janë të shkëlqyeshëm, por që nuk kanë mundur të regjistrohen në universitetin publik e të tillë ka edhe studentë që janë fëmijë të dëshmorëve, pastaj sqaroi përmbajtjen e nenit 6.2 dhe nenit 11. Mandej lidhur me nenin 16, sqaroi se është e drejtë ligjore që kryetari i komunës të formojë komisione. Te neni 12.1 kërkoi që të korrigohej një gabim teknik ku në vend të nenit 11 duhet të jetë neni 10.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar universiteteve private, tha se do të ishte mrekulli sikur të kishte universitete private të licencuara, por këtu bëhet fjalë për kolegje dhe me një cilësi shumë të ulët të mësimi.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se titulli i draft-rregullores në fjalë duhet të jetë i shënuar ndaras prej thirrjeve juridike. Kurse lidhur me nenin 11, tha se pëlqimin për doktoraturë duhet ta marrë nga institucionet qendrore, duke shtuar se doktoratura pas luftës ka filluar të degradohet totalisht, pasi që ka një numër të madh të doktorantëve të shkencave që po dalin pa një kontroll të nevojshëm. Pastaj lidhur me nenin 5 kërkoi që termi "djem e vajza" të zëvendësohet nga termi "nxënës dhe

nxënësve”. Në fund kërkoi të futet një nen i veçantë për stimulimin dhe përkrahjen e nxënësve me inteligjencë të veçantë.

Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se talentët e veçantë nuk përkrahen dhe stimulohen me një ndihmë, por për ta Drejtoria për Arsim ose edhe Ministria e Arsimit duhet ta formojë një program të veçantë për këtë kategori të nxënësve. Po ashtu shprehu pajtimin e saj se niveli komunal nuk është kompetent të merret me ndarjen e bursave për studimet e doktoraturës. Në fund tha se do të ishte mirë që në të ardhmen të hartohet një rregullore e veçantë për ndarjen e bursave për nxënësit.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- propozoi që sa më shpejt të jetë e mundur të hartohet një rregullore e veçantë për nxënësit. Pastaj kërkoi që nga kjo draft-rregullore të hiqet fjala “doktoratë”, sepse në kuadër të universiteteve ekziston një komision i veçantë për hulumtime shkencore dhe i njëjti i akordon këto bursa. Në fund tha se universitet private nuk janë të licencuara, por këto mund të jenë vetëm kolegje, prandaj ne biem në kundërshtim me ligjin, nëse iu ndajmë bursa atyre që punojnë ilegalisht.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- shprehu pajtimin e tij që neni 11 të hiqet nga kjo draft-rregullore. Po ashtu kërkoi që të mos zhvlerësohen studentët që janë të regjistruar nëpër kolegje private.

Qerim Selimi, drejtor i DĀ-së- lidhur me universitetet private, tha se ekziston një udhëzim administrativ i Ministrisë së Arsimit, ku e bën dallimin në mes të universiteteve private, kolegjeve dhe shkollave private, prandaj kërkoi që termi “universitete private” të zëvendësohet me termin “kolegje private”. Kurse për emërtimin e rregullores propozoi që në emërtim të saj të përfshihet edhe ndarja e bursave për shkollim të nxënësve.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me titullin e draft-rregullores propozoi emërtimin “Rregullore për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve”, pasi që propozoi që fjalia “bursa për nxënës” të zëvendësohet me fjalinë “shpërblime për nxënës të dalluar të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta”. Sa i përket paragrafit 3.3, propozoi që nga ky paragraf të hiqet doktoratura dhe specializimet e ndryshme. Në fund tha se në Kosovë janë hapur disa universitete publike, prandaj studentët që dëshirojnë studime në universitete publike kanë mundësi të zgjedhin dhe për këtë arsye kërkoi që të merret një qëndrim për t’i ikur privatëve.

Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar diskutimeve të deritanishme të anëtarëve të KK-së lidhur me draft-rregulloren në fjalë, paraqiti këtë përmbledhje të propozimeve që duhet inkorporuar: për nxënësit të jetë termi “shpërblim”; formimi i komisionit për ndarjen e bursave le të mbetet kompetencë e kryetarit të komunës, por komisioni obligohet që ta informon kuvendin e komunës; bursat që janë propozuar për 10 muaj, le të mbeten për 12 muaj; hiqet neni 11, si dhe hiqen termet “doktoraturë dhe specializime” në çdo nen ku përmenden këto dy terme; te neni 8 të thuhet “universitete publike dhe kolegje universitare private”.

Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit- duke iu referuar nenit 6.1, tha se nëse bëhet vlerësimi në bazë të kriterit të notave, atëherë 80 % të studentëve të kolegjeve private do të përfitojnë bursa, sepse atje është nota shumë e lirë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 32 vota “për”, 1 “kundër” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimeve për nxënës, duke inkorporuar edhe shumicën e propozimeve të anëtarëve të KK-së.

4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për dhënien e dekoratave (shqyrtimi i dytë).

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, tha se nuk kishte rekomandime nga diskutimi publik. Pastaj tha se edhe më herët ka paraqitur vërejtje për çmimet te nenet 5, 6 dhe 7, pasi që për to nuk parashihet motivacioni, prandaj duhet të qëndrojë motivacioni për çka jepet çmimi. Kurse vërejtja tjetër ka të bëjë me paragrafët 5.8, 6.6 dhe 7.6, të cilët flasin për ndarjen e titullit, duke propozuar këtë formulim: "Çmimin e jep kryetari i komunës në mënyrë solemne, sipas procedurave të parapara me protokollin e komunës apo i deleguari i tij".

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- te neni 5.1 propozoi që në vend të "shkencëtarëve, shkrimtarëve dhe artistëve" të bëhet "shkencore, letrare dhe artistike". Po ashtu te neni 5.2 mund të inkorporohet "personaliteteve ushtarake".

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- kërkoi që në draft-rregulloren në fjalë të inkorporohen edhe disa prej çmimeve që janë paraparë përmes Strategjisë për Informim dhe Komunikim, e cila është miratuar muaj më parë.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, tha se edhe gjatë shqyrtimit të parë janë dhënë vërejtje, por hartuesi nuk i ka inkorporuar në draft-rregullore. Po ashtu gjatë shqyrtimit të parë është kërkuar që për çdo çmim të ketë motivacion.

Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit- te neni 11 propozoi që çmimi "beregëti" të zëvendësohet me emërtimin "begatia". Po ashtu te paragrafi 11.4 është një gabim teknik, ku thuhet "emri dhe mbiemri i fitueses", që e paragjykon se fituesja duhet të jetë femër. Kurse te neni 12 propozoi një paragraf të ri me të cilin përcaktohet numri i ndarjes së mirënjohjeve dhe falënderimeve.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- lidhur me nenin 10.7, tha se nga cilatdo institucione të bëhet iniciativa, ajo duhet të jetë në formë të shkruar dhe të argumentuar.

Qamil Sahiti, drejtor i DKRS-së- sqaroi se të gjitha çmimet e parashikuara në Strategjinë për Informim dhe Komunikim janë përfshirë në draft-rregulloren në fjalë. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-rregulloren në fjalë.

Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit- tha se në draft-rregulloren në fjalë janë disa gabime teknike tek radhitja e neneve, prandaj kërkoi që të korrigjohen.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, propozoi që çmimi "beregëti" të emërtohet "sofra jonë".

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për dhënien e dekoratave, duke inkorporuar edhe shumicën e propozimeve të anëtarëve të KK-së.

5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronë e paluajtshme për vitin 2014 (shqyrtimi i parë).

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se te thirrjet juridike duhet të futet edhe Ligji nr. 04/L-100, sepse me këtë ligj shkalla e tatimit është prej 0.15 deri në 1 %. Kurse sa i përket nenit 6, paraqiti këto propozime: për pronën rezidenciale (banesë-apartament) 0.15 %; për pronën rezidenciale – shtëpi 0.15 %; për pronën komerciale 0.25 %; për pronën industriale 0.15 %; për pronën bujqësore 0.15 %; për pronat e pamermetuara dhe jo të gatshme për banim 0.15 %; garazhet 0.15%; kurse pronat e braktisura propozoi që të hiqen nga tatimimi, në mënyrë që të mos ngarkohet buxheti kot; për pronat komerciale 0.15 %, pasi që e kanë sezonën e shkurtër të veprimtarisë; për pronat e pamermetuara dhe jo të gatshme komerciale 0.20 %. Sa i përket nenit 8, tha se pasi që ligji e parasheh që vlera e tatimit të pronës të jetë vlera e tregut, por duke u bazuar në këto çmime (të

propozuara në këtë draft-rregullore) nuk është nxjerr as vlera e tregut, por as vlera e kostos, e as nuk është nxjerr vlera në bazë të kontratave, dhe shtoi se kontratat e shitblerjes duhet të revidohen dhe të rivlerësohen. Në vazhdim lidhur me vlerën e tregut në € për m² sipas zonave, propozoi disa korrigjime te zona e I-rë për pronën rezidenciale-shtëpi dhe për pronën komerciale, me ç'rast kërkoi që komisioni në fjalë të ketë pavarësi në vlerësimin e pronave, duke u bazuar në çmimin e tregut.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se nëse iu referohemi informatave të paraqitura lidhur me të hyrat e komunës, është parë se niveli i inkasimit të të hyrave nuk është i kënaqshëm, prandaj pyeti se Drejtoria për Buxhet dhe Financa a e ka shikuar gjendjen e inkasimit të të hyrave vetanake nga tatimi në pronë, por nëse e krahasojmë me Rregulloren e tatimit në pronë, për vitin e kaluar, në mënyrë që hartimi i kësaj rregulloreje të bazohet në parametra real, pasi që ka raste kur planifikimi ka qenë tepër ambicioz, por realizimi ka qenë i ulët, prandaj kërkoi që Drejtoria për Buxhet dhe Financa të analizojë mirë gjendjen e inkasimit të të hyrave vetanake nga tatimi në pronë, duke iu dhënë hapësirë edhe qytetarëve për vlerësimin e draft-rregullores në fjalë, pasi që në bazë të informatave të tij ka një vlerë të madhe të tatimit në pronë të painkasuar.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, tha se shihet që ka ndryshuar ndarja e zonave, por zonat nuk mund të ndryshohen vetëm nga ekzekutivi pa u shqyrtuar edhe në kuvendin e komunës, sepse ndryshimi i zonave duhet të ndodh përmes nxjerrjes së vendimit nga kuvendi. Pastaj tha se në zonën e parë nuk mund të përfshihet ajo që është në qendër dhe të krahasohet me pjesën e cila është në dalje të qytetit, prandaj kërkoi që të shikohet edhe njëherë se çka duhet të përfshihet në zonën e parë, sepse nuk mund të krahasohen bizneset që zhvillojnë aktivitetin përgjatë rrugës "Dëshmorët e Kombit" me pjesën e rrugës përtej ndërtesës ku ka qenë Kosova e Vushtrrisë. Po ashtu kërkoi që të definohet çështja e pronave të braktisura. Në fund tha se ka dallim shumë të madh në mes të pronës industriale dhe pronës bujqësore, kurse dallimi te baza tatimore në mes tyre në zonën e parë është shumë i vogël, pasi që pronat industriale kanë përfitime të mëdha, kurse pronat bujqësore punojnë me humbje dhe në të gjitha vendet e botës këto prona stimulohen, sepse çështja e bujqësisë është çështje humane.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se pas thirrjeve në dispozitat ligjore, duhet të vendoset emërtimi i kësaj rregulloreje. Pastaj kërkoi nga hartuesi që në rastin e shqyrtimit të dytë, të shqyrtohet mundësia që zona e parë të ndahet në tri apo katër nënzona, pasi që nuk është e njëjtë vlera e tregut sikur në qendër të qytetit dhe në periferi të qytetit. Po ashtu tha se edhe në vitin e kaluar ka kërkuar që të shikohet mundësia e tatimit sipas etazhitetit, sepse nuk është vlera e njëjtë në treg për të gjitha katet.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-rregulloren në fjalë, si dhe paraqiti sqarime për vërejtjet e anëtarëve të KK-së lidhur me këtë draft-rregullore.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për territorin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2014.

Diskutimi publik fillon nga data 26.07.2013 dhe zgjatë deri më 26.08.2013.

6. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se informata në fjalë vë në pah inkasimin e ulët dhe planifikimin jo të mirë të DBF-së, duke shtuar se ka gabime edhe në kalkulime, si dhe është e çuditshme që edhe përqindjet janë rumbullaksuar e që një gjë e tillë

nuk ka logjikë. Pastaj te zyra e kryetarit, tha se nuk duhet të figurojë emërtimi "të hyrat e realizuara", sepse zyra e kryetarit nuk realizon të hyra, prandaj emërtimi adekuat është "mjetet e shpenzuara". Po ashtu pyeti drejtorin pse është kjo rritje e shpenzimeve apo cilat janë aktivitetet shtesë, si dhe a përkon kjo rritje me rezultatet e zyrës së kryetarit, pasi që në vitin e kaluar kanë qenë 69.098 €, kurse në këtë vit janë planifikuar 80.782 €. Mandej tek administrata ka rritje të shpenzimeve nga të hyrat vetjake prej 25.000 €, prandaj për këtë kërkoi sqarim. Po ashtu te inspeksioni është rrit planifikimi i grantit qeveritar, kurse për vitin 2014 nuk janë planifikuar të hyra vetjake; te buxheti dhe financa ka një diskrepancë të madhe te qiraja; kurse te prokurimi për të hyrat vetjake nuk ka pas as përqindje dhe as planifikim, por janë realizuar të hyra vetjake në vlerë prej 7,895.35 €, prandaj kjo flet për nivelin e planifikimit; te zyra e kuvendit komunal ka një zvogëlim të planifikimit dhe për këtë kërkoi sqarim pse ka ardhur deri te ky zvogëlim; te urbanizmi ka diskrepancë në realizimin e të hyrave; donacionet e brendshme kanë një rënie të madhe; gjithashtu edhe gjobat e trafikut; te shërbimet publike ka një rritje enorme të planifikimit, prandaj kërkoi sqarime për këtë rritje enorme të planifikimit, duke shtuar se edhe këtu përqindjet janë të rrumbullaksuara pa nevojë. Në vazhdim tha se është zvogëluar granti për bujqësi, si dhe të hyrat vetjake janë më të ulëta, duke shtuar se të hyrat vetjake te bujqësia janë planifikuar të njëjta me vitin paraprak, kurse janë realizuar edhe më pak dhe për këtë kërkoi sqarim. Te gjeodezia dhe kadastrri ka planifikim të të hyrave në vlerë prej 17.500 €, kurse realizimi është 0 %, ndërsa te kultura, rinia dhe sporti nuk ka fare total dhe as përqindje kumulative; te arsimiti ka një zvogëlim të grantit qeveritar dhe të të hyrave vetjake, duke shtuar se është e paqartë pse ka pas planifikim të zvogëluar. Në fund tha se në përgjithësi shpenzimet janë realizuar vetëm 61 %, e që ka pas mundësi objektive të jenë më të mëdha.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- lidhur me informatën në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të AAK-së tha se të hyrat e planifikuara në krahasim me ato të realizuara janë 76 %, ku pjesa më e madhe e drejtorive kanë ngecje në realizimin e planifikimit të të hyrave. Po ashtu te faqja e shpenzimeve sipas burimit të financimit shihet se qeveria lokale ka arrit që t'i shpenzojë vetëm 61 % të mjeteve për këtë periudhë 6-mujore edhe përkundër nevojave të mëdha të qytetarëve. Mandej te shpenzimi i mjeteve sipas drejtorive shihet se pjesa më e madhe e drejtorive kanë planifikuar të shpenzojnë mjetet, por nuk kanë arritur t'i shpenzojnë ato mjete në nivel të kënaqshëm, dhe kjo flet për një mosmenaxhim profesional të nevojave të tyre. Në fund tha se në bazë të kësaj informate, shihet se qeveria lokale për këtë 6-mujor ka treguar një performancë të dobët në shpenzimin e mjeteve prej 61 %, një performancë të dobët të mbledhjes së të hyrave vetanake prej 76 %, një performancë të dobët të shpenzimit të mjeteve sipas drejtorive, dhe një performancë të dobët të shpenzimit të mjeteve për investime kapitale prej 37 %.

7. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2012.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se ka rezerva të mëdha në objektivitetin e auditorit gjeneral. Pastaj tha se pasi që pasqyrat financiare janë vlerësuar me opinion të pakualifikuar me theksim të dy çështjeve, dhe kjo notë është e shkëlqyeshme, mirëpo realiteti është ndryshe, shtoi se është keq nëse drejtoria në fjalë i beson këtij raporti dhe qëndron e kënaqur. Pastaj lidhur me pasqyrat vjetore financiare lexoi rekomandimet që i janë dhënë kryetarit të komunës, pasi që në bazë të të gjeturave nuk janë implementuar të gjitha rekomandimet e vitit paraprak dhe nuk ka pas llogaridhënie. Mandej tha se auditori gjeneral te vlera e pagesave të ekzekutuara ka gjetur pagesa prej 133.400 € nga palët e treta të pashpalosura në pasqyra financiare. Kurse tek asetet thuhet se vlera e pasurive prej 36,639.248 € nuk është e plotë dhe e saktë, sepse nuk është bërë

regjistrimi i pasurive të financuara nga ministritë e linjës, prandaj shtoi se edhe në vitin e kaluar i ka rekomanduar kryetarit të komunës që të angazhojë një kompani prestigjioze për vlerësimin e aseteve, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Në vazhdim tha se auditori gjeneral ka konstatuar se komuna ka inkasuar vetëm 65 % të të hyrave vetjake ndaj atyre të planifikuara, por shtoi se në raportin final që ka pasur KK-ja në vitin e kaluar ka qenë një shifër tjetër. Po ashtu tha se e gjetura me të cilën drejtorja duhet të merret seriozisht është testimi i nëntë mostrave, ku në shkollën "Lutfi Musiqi" janë inkasuar nga 8 € për çdo lëndë, e cila është në kundërshtim me UA 11/2011 të MASHT-it. Në fund te vonesa në kryerjen e punimeve, tha se komuna nuk ka paraparë gjoba.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- lidhur me raportin në fjalë, tha se te auditimi i pasqyrave financiare shihet se nuk ka ndonjë përmirësim të theksuar në krahasim me auditimin e vitit 2011, dhe shtoi se si dobësi paraqiten pagesat nga palët e treta të paevidentuara në planin kontabël, regjistrimi i pasurive të komunës dhe rekomandimet e vitit 2011 nuk janë përfillur plotësisht, kurse në vazhdim përmendi edhe vërejtjet tjera që kanë dalë nga raporti në fjalë. Pastaj për prokurimin është paraqitur vërejtja se nuk ka formuar komision për pranimin e shërbimeve. Mandej thuhet se subvencionet dhe transferet janë realizuar 99 %, por është kërkuar që ato të mbulohen me raporte financiare të shpenzimit të mjeteve dhe paraprakisht të bëhet një marrëveshje e mirëkuptimit. Në fund tha se po të merret një grup i ekspertëve për ta audituar Komunën e Vushtrrisë vetëm në dy drejtori, do të kishin gjetur parregullsi të mëdha.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se rekomandimet e dhëna kanë peshën dhe rëndësinë e vet. Pastaj tek të gjeturat dhe rekomandimet, tha se e gjetura nr. 11 ku thotë se katër shërbyesve civil ju mungojnë akt-emërimet dhe katër mësimdhënësve ju mungojnë kontratat e punës për vitin 2012, por e keqja është që nuk ka të dhëna që e arsyetojnë pagesën e tyre. Po ashtu tha se një dukuri që është me rëndësi dhe po mungon, është çështja e regjistrimit të shumë projekteve kapitale në komunë, sidomos të atyre që janë të ndërtuara nga granti qeveritar dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, prandaj konstatoi se kjo gjendje është krijuar si rezultat i mungesës së bashkëpunimit në mes të institucioneve lokale dhe atyre qendrore. Në vazhdim tha se një anomali tjetër është lidhja e dy kontratave për furnizim me material zyrtar, prandaj edhe ky është një element që flet për nevojën e një menaxhimi të mirëfilltë. Në fund tha se të gjitha këto rekomandime kanë qëllimin e mirë për të ngritur përgjegjësinë dhe të bëhet një plan i mirë i veprimit për menaxhim të mirëfilltë të të gjitha mjeteve buxhetor në komunë.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- tha se auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2012 është në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik. Pastaj tha se Komuna e Vushtrrisë mburret që tri vite radhazi ka fituar opinionin e pakualifikuar (që është vlerësimi më i lartë) nga auditorët gjeneral, sepse për ta fituar këtë vlerësim nevojitet punë dhe angazhim shumë i madh. Po ashtu tha se pas rekomandimeve të dhëna nga auditori gjeneral, autoritetet komunale menjëherë kanë hartuar planin e implementimit i cili do të zbatohet deri në fund të vitit, duke iu përmbajtur të gjitha rekomandimeve të paraqitura nga auditori gjeneral.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar fjalisë (faqe nr.7 të raportit në fjalë) "të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë", prandaj shtoi se kryesisht ka raste të auditimit të shumave të vogla deri në 3.000 €, prandaj është e tepërt deklarata se vlerësimi nga auditori gjeneral është për mburrje, sepse nuk është gjendja reale në terren ashtu siç paraqitet në dokumente, dhe përmendi si shembull shtrimin me cilësi të dobët të rrugëve me asfalt në fshatrat Tërllobuq dhe Sllatinë.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- lidhur me raportin në fjalë tha se konkluzioni i auditorit të përgjithshëm është se kryetari i komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm në nivel të kënaqshëm, por këto duhet në vazhdimësi të monitorohen për t'u siguruar se janë duke funksionuar siç duhet. Janë vërejtur mangësi në disa fusha të cilat janë përshkruar në raport. Pastaj te menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë kërkuar që kryetari i komunës të sigurojë ndërmarrjen e masave të nevojshme për t'i adresuar të gjitha rekomandimet dhe të forcojë të gjitha linjat e llogaridhënies, prandaj në këto vërejtje shumë serioze të auditorit gjeneral është gjithçka e qartë dhe nuk ka nevojë për ndonjë analizë të një ekonomisti, pasi që kërkohet të ndërmerren masa për përmirësim në të ardhmen.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se vlerësimi i auditorit gjeneral është shumë pozitiv për Komunën e Vushtrrisë, kurse rekomandime do të ketë për çdo vit. Po ashtu tha se në vitin 2012 është bërë një punë e mirë dhe paratë publike janë shpenzuar në mënyrë të duhur dhe transparente.

8. Shqyrtimi i Draft-rregullores për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve (shqyrtimi i parë).

Idriz Ismajli, drejtor i DUMM-së- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me draft-rregulloren në fjalë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- lidhur me draft-rregulloren në fjalë, propozoi që gjatë procedurës të shikohet elementi i shkurtimit të afateve rreth lejeve të ndërtimeve, në mënyrë që të respektohet limiti ligjor, për t'u krijuar një ambient më i sigurt në Komunën e Vushtrrisë për investitorët e mundshëm.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se ka edhe ligje në fuqi për këtë çështje, por ka pasur shkelje të natyrave të ndryshme lidhur me: ndërtimin e objekteve ndërtimore, rrethojat rreth objekteve, zbatimin e standardeve për hapësirat gjelbëruese rreth ndërtesave, mosrespektimin e hapësirave për vendparkingje, po ashtu janë ndërtuar objekte shumëkatëshe që nuk kanë fare hapësirë për trotuar. Në fund pyeti hartuesin e kësaj draft-rregulloreje se pas hyrjes në fuqi të rregullores në fjalë si do të rregullohet çështja e atyre shkeljeve që janë bërë deri më tani (sepse gjendja faktike bie ndesh me këtë rregullore), dhe a do të ketë veprim retroaktiv duke u bërë përmirësime ku është e mundshme.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Rregullat dhe Procedurat e Ndërtimit të Objekteve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 26.07.2013 dhe zgjatë deri më 26.08.2013.

9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë në shkollat fillore dhe të mesme në Komunën e Vushtrrisë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se informata në fjalë nuk është e plotë. Pastaj tha se është shqetësues numri i madh i mungesave të nxënësve në tri shkollat e mesme të larta, prandaj është e nevojshme që të analizohet kjo situatë. Mandej tha se në informatë nuk janë paraqitur mungesat e mësimeve dhe po ashtu në këtë informatë është dashtë të përmendet çështja e punës praktike. Në vazhdim tha se gjithashtu është dashtë të flitet gjerësisht për mësimin me nxënësit me aftësi të kufizuara në dy paralelet. Në fund përmendi edhe problemin e vlerësimit të jashtëm të kalueshmërisë dhe arritshmërisë, duke shtuar se vetëm klasat e V-ta kanë kaluar mbi mesataren, kurse kanë mbetur nën mesataren klasat VI, VII, VIII dhe IX-të.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të LDK-së tha se në faqen nr. 4 shihet se kalueshmëria për arsimin fillor (1-5) ka qenë 98.67 %, që krahasuar me gjysmëvjetorin e parë suksesi është ngritur 1.8 %, kurse për arsimin e mesëm të ulët (6-9) suksesi ka qenë 96.7 %, që krahasuar me gjysmëvjetorin e parë suksesi është ngritur për 27.5 %, dhe shtoi se nga kjo nënkuptohet se mësimdhënësit në arsimin e mesëm të ulët e kuptojnë se kanë nxituar me vlerësime të ngutshme, pastaj bëjnë përmirësime fiktive, prandaj duket se ka një përmirësim prej 27 %. Mandej për shkollat e mesme të larta thuhet se është ngritur suksesi me sa vijon: në shkollën "Eqrem Çabej" 42.29 %; në shkollën "Lutfi Musiqi" 44.04 % dhe në shkollën "Bahri Haxha" 39.61 %, me ç'rast shtoi se këtu bëhet fjalë për përmirësimin fiktiv të suksesit me nota e jo në kuptimin përmbajtësor. Po ashtu tha se gjendja është e keqe edhe nëse analizohet testi i maturës në shkollat e mesme, prandaj kërkoi nga drejtori i Drejtorisë për Arsim që të zëvendësohen me drejtorë të tjerë ato shkolla ku ka mungesa të shumta dhe ku nuk ka menaxhim të mirë të shkollave. Në vazhdim lidhur me vështirësitë e përmendura gjatë kësaj periudhe nëpër shkolla, pyeti se sa mësimdhënës kanë qenë me sëmundje kronike dhe në cilat shkolla, dhe shtoi se në SHMU 2 janë klasat e mykura, prandaj edhe prindërit janë ankuar se si rezultat i mykut janë sëmurë fëmijët e tyre. Gjithashtu pyeti se sa është numri i nxënësve në klasë të kombinuara dhe sa është numri i klasave të kombinuara, po ashtu të sqarohet se në cilat shkolla kanë munguar fushat sportive, kabinetet e informatikës, laboratorët e kimisë, fizikës dhe biologjisë, si dhe tekstet shkollore për nxënësit e shkollave të mesme profesionale. Në fund në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi nga drejtori i Drejtorisë për Arsim që të ndërmer masa për përmirësimin e gjendjes.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- lidhur me informatën në fjalë, tek faqja nr.2 kërkoi që fjala "bunar" të zëvendësohet me fjalën "puse". Pastaj tha se është shqetësues dallimi i suksesit në mes të klasës së V-të ku është kalueshmëria 65,47 %, kurse në klasën e VI-të kalueshmëria është 39,03 %, prandaj kërkoi që të analizohet puna dhe kriteri i notimit të mësimdhënësve në nivelin e ulët të arsimit. Mandej sa i përket rezultateve të testimeve të maturës shtetërore, tha se për gjimnazin "Eqrem Çabej" është pritur ky rezultat, duke arsyetuar se kjo ka ardhur si rezultat i gjeneratave shumë të mira, pasi që çështja e kriterit të pranimit e përcakton rezultatin në testin e maturës, por është brengosëse gjendja në dy shkollat e mesme (teknike dhe profesionale), ku në SHMT "Lutfi Musiqi" nga 401 nxënës, me sukses pozitiv janë 172, prandaj është e nevojshme të analizohet gjendja në këto shkolla për ta kuptuar se a është në pyetje faktori njeri apo gjatë pranimit të nxënësve nuk është duke u zbatuar një politikë gjithëpërfshirëse, duke shtuar se trendi i zhvillimeve ekonomike kërkon nxënës me përgatitje profesionale dhe teknike. Në fund tha se edhe te SHMP "Bahri Haxha" është një sukses tepër i dobët, përkundër faktit se kjo shkollë tash për tash i ka kushtet.

Qerim Selimi, drejtor i DĀ-së- paraqiti sqarime shtesë lidhur me diskutimet e anëtarëve të KK-së për informatën në fjalë. Po ashtu tha se për mungesat e mësimdhënësve, Drejtoria për Arsim bën ndalesa, duke shtuar se kjo formë e ndalesave ka ndikuar pozitivisht në zvogëlimin e mungesave.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi nga drejtori i Drejtorisë për Arsim që në të ardhmen kur të paraqiten informata të tilla, të bëhet një ranglistë e suksesit nëpër shkolla dhe kërkoi që ata të cilët punojnë mirë të stimulohen.

10. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen shëndetësore të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të LDK-së paraqiti këto vërejtje: vizita ka shumë, kurse participime

pak, shërbimet e rëntgenit dhe laboratorit nuk janë ndarë, ngarkesa është shumë e madhe tek shërbimi emergjent, imunizimi është arma më e fortë tek gjeneratat e reja. Pastaj tha se paraqitja e sëmundjeve ngjitëse nuk është pasqyruar në mënyrë komplete, prandaj kërkoi që të kompletohet në përfundim të vitit. Në fund kërkoi që Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të përgatitë një informatë për gjendjen sociale të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se bazuar në ligjet në fuqi për këmbimin e pronës, së pari është dashtë të shikohet interesi i komunës e pastaj interesi reciprok. Mandej tha se me rastin e interesimit të investitorit për të investuar në ndërtimin e objektit të komunës, ai së pari dëshiron ta ketë dokumentacionin e kompletuar nga komuna, prandaj pyeti se në çfarë forme iu është servuar dokumentacioni, kur ka qenë një pjesë e parcelës e pronarit X (iks). Po ashtu pyeti se a është bërë e ditur me kohë që duhet të bëhet shpronësimi. Në fund pyeti se a ka pasur marrëveshje të brendshme (të mëhershme) në mes të përfaqësuesve të komunës dhe pronarit të parcelës.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se edhe në rastet tjera kur ka qenë në pyetje prona komunale, ka kërkuar që në raste të tilla vendimi të jetë sa më bindës dhe argumentues para kuvendit të komunës, prandaj edhe në këtë rast përgjegjësit komunal do të duhej ta incizonin vendin ku ka qenë objekti i pronarit X (iks). Po ashtu tha se në lëndën e këtij propozim-vendimi nuk dihet se kush ka kërkuar raportin e vlerësimit nga Ministria e Financave dhe nuk dihet mënyra sesi e ka caktuar kjo ministri këtë kompani për bërjen e vlerësimit të pronës së paluajtshme, prandaj propozoi që ky propozim-vendim të shtyhet për një mbledhje tjetër të KK-së, në mënyrë që të përgatitet më mirë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, kërkoi sqarim tek përshkrimi i pronës ku thuhet se: “në parcelë ka ndërtim i cili nuk merr pjesë në këmbim pasi objekti është ndërtuar pas ndërrimit të pronave”, duke shtuar se ky vlerësim është bërë me 23.11.2011 dhe nëse e ka ndërtuar pronari privat në pronë të komunës para vitit 2011 dhe e ka shfrytëzuar deri tani, prandaj pyeti sesi e ka shfrytëzuar ai në këtë periudhë kaq të gjatë, si dhe kanë kaluar dy vite dhe nuk paska ndërruar fare vlera e tregut për këtë pronë, përkundër investimeve që është duke i bërë komuna në atë pjesë të qytetit, dhe për këtë arsye Grupi kuvendar i LDK-së nuk do ta votojë, pasi që vlerëson që kjo formë e këmbimit të pronave është e dyshimtë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se propozim-vendimi në fjalë duhet të aprovohet, pasi që është në interesin e komunës, si dhe në interesin e qytetarëve që të ndërtohet objekti i komunës.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore- paraqiti sqarime shtesë lidhur me të gjitha procedurat në mënyrë kronologjike për nevojën e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- te çështja e vlerësimit të vlerës së pronës thuhet se “vlera e tregut është shuma e përafërt e vlerësuar për të cilën një pronë do të shkëmbehet në datën e vlerësimit”, dhe shtoi se nga kjo fjali nënkuptohet që vlerësimi të bëhet brenda një afati të arsyeshëm e jo pas dy viteve.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- lidhur me dokumentin e raportit të vlerësimit, tha se në fillim të tij është e vendosur logoja e shtetit të Kosovës dhe përmendet Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Financave, prandaj pyeti se me çfarë logjike në fund të këtij dokumenti është vendosur vula e një kompanie private.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke i referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se duhet me pas parasysh çështjen e validitetit të vlerësimit në mes të datës së marrjes së vendimit dhe dy vjet prapa, prandaj për këtë çështje kërkoi sqarim.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore- tha se për pronën në fjalë, pronari ka dhënë pëlqimin për këto kushte që janë paraqitur në këtë lëndë, sepse nuk ka qenë e mundur të kërkohet pëlqimi nga pronari pa e pasur vlerësimin, duke sqaruar se ligji nuk e përkufizon në mënyrë taksative që vlerësimi vlen për një periudhë të caktuar.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në me 19 vota “për”, 7 “kundër” dhe 1 “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim Komuna e Vushtrrisë bën këmbimin e pronës së paluajtshme Nr.P-70202016-00605/1, e cila është e regjistruar në certifikatën e pronësisë: UL-70202016-00045 në sipërfaqe prej 98 m², Zona Kadastrale Vushtrri (e cila gjendet në rr. “Dëshmorët e Kombit” (përballë objektit të Gjykatës), me parcelën Nr.P-70202016-00691/2, pronë e z. Ruzhdi Ukiqi nga Vushtrria, e cila është e regjistruar në certifikatën e pronësisë: UL-70202016-02933, në sipërfaqe prej 88 m², Zona Kadastrale Vushtrri (e cila gjendet në ish tregun e qytetit-afër objektit të komunës).

Obliqohet z.Ruzhdi Ukiqi-pronar i paluajtshmërisë nr.691/2 që t’ia kompensoj Komunës së Vushtrrisë diferencën e vlerës së paluajtshmërisë në shumë prej: 37,800.00 € (tridhjeteshtatë mijë e tetëqind euro), duke e ndarë në tri rata në shumë proporcionale:

Rata e parë në afat prej 15 ditësh prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

Rata e dytë në afat prej 3 muaj prej pagesës së ratës së parë dhe

Rata e tretë në afat prej 3 muaj prej pagesës së ratës së dytë.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për aprovimin e listës për emërtimin e rrugëve dhe shesheve, si dhe kompensimin e anëtarëve të Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit- tha se edhe më herët me shkrim iu është propozuar kuvendit të komunës që rrugës “Pandeli Sotiri” t’i vihet emri “Bedri Bajgora” me arsyetimin se në vitin 1982 ka ardhur në arkivol dhe i njëjti ka qenë student i dalluar.

Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit- tha se komisioni për emërtimin e rrugëve ka bërë një punë shumë të mirë, ku falë kësaj pune Komuna e Vushtrrisë ka arritur që të jetë ndër komunat e para sa i përket emërtimit të rrugëve dhe shesheve.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se Grupi kuvendar i LDK-së është i shqetësuar me emërtimet e bëra të rrugëve, pasi që ka lëshime të mëdha, madje ka edhe lëshime skandaloze, por ka edhe lëshime ligjore, pasi që në propozim-listë figurojnë 3-4 emra të njerëzve të gjallë, kurse mungojnë emërtimet e rrugëve me emra të figurave eminente të historisë dhe arsimit shqip, prandaj në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që kjo listë e rrugëve të shkon në diskutim publik e pastaj të vjen në kuvendin e komunës.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke i referuar propozim-listës me emrat e rrugëve, tha se emrat e të gjallëve nuk bën të futen në emërtimin e rrugëve. Pastaj tha se duhet me pas kujdes që të përfshihen emrat e personaliteteve nga lëmi të ndryshme, nga e kaluara ose nga historia e tanishme dhe përmendi emrin e Muharrem Berishës nga fshati Vilanc, i cili deri më tani është i vetmi që në Komunën e Vushtrrisë ka pasur titullin e akademikut, prandaj emrin e tij duhet ta mbajë me krenari një institucion edukativ-arsimor në Komunën e Vushtrrisë. Mandej tha se një njeri që dikur ka qenë i përndjekur nga koha e regjimit, i cili ka qenë edhe një ekspert juridik, kryetar i një qeverie komunale dhe anëtar i kuvendit të komunës,

prandaj është mburrje për qytetin e Vushtrrisë që të figurojë edhe emri i Muharrem Parduzit në propozim-listën në fjalë. Në vazhdim përmendi Ramadan Kastratin, i cili ka qenë kushëri dhe bashkëlufëtari i afërt i Shaban Polluzhës e i cili nuk është përfshirë në këtë propozim-listë. Po ashtu përmendi emra të merituar që janë propozuar nga Samadrexha, por që mungojnë në propozim-listën në fjalë, siç është emri i axhës së tij, i është vrarë për çështje kombëtare duke shkuar në Greqi, prandaj kërkoi që të përfshihet edhe emri i tij. Gjithashtu mungon emri i Avdyl Bashollit, njeriu që ka qenë bashkëpunëtor në luftën e dytë botërore dhe është vrarë, kurse është e padrejtë që është propozuar emri i bashkëlufëtari të tij, i cili ka vdekur nga vdekja natyrore. Në vazhdim tha se mungon propozimi me emrin e Shahin Malokut nga Samadrexha, i cili ka qenë ndër më të maltretuarit në atë kohë gjatë aksionit të armëve, kurse në listë figurojnë emra të tjerë që nuk e kanë peshën e tij, prandaj kërkoi që të mos bëhen gabime të tilla, duke i harruar njerëzit e sakrificës dhe kërkoi nga komisioni në fjalë që t'i bëjë disa përmirësime, duke i hequr nga lista emrat e personave të gjallë.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-listës në fjalë, shprehu brengën e tij që nuk ka qenë në rrjedhë të procesit, pasi që nuk ka qenë i ftuar, sepse mungojnë shumë emra të merituar në qytet, siç janë: Enver Zymberi, i cili është heroi i fundit që ka rënë për lirinë e Kosovës; prof. dr. Qenan Tunuzliu, i cili ka qenë akademik dhe ndër doktorët e parë të Komunës së Vushtrrisë dhe ka qenë profesor inordinar; Ramadan Shala, Sefedin Shala; prof. dr. Ali Shala, djemtë e Hajrullah Shalës, të cilët kanë kontribuar shumë për Kosovë, për komunë, për arsimimin dhe emancipimin e kombit shqiptar; Mulla Ilaz Pllana, i cili në vitin 1922, 1926 dhe 1928 e ka penguar shpërnguljen e shqiptarëve për Turqi; Ali Buçinca, i cili ka qenë farmacisti i parë në komunë dhe në Kosovë, si dhe babai i tij ka qenë trupprojë e Isa Boletinit; Isa Buçinca, i cili ka qenë veteran i arsimit, kurse Ramizi është babai i tyre, i cili është vrarë më 1946 si kryesues i NDSH-së dhe trupprojë e Isa Boletinit; Shaban Merovci, i cili ka qenë doktori i parë shqiptar në Komunën e Vushtrrisë në vitin 1964; Latif Berisha, shkrimtar i nderuar dhe profesor; hoxha i Morinëve së bashku me të vllaun, i cili ka qenë kryesues i NDSH-së dhe trupprojë i kryeministrit shqiptar Rexhep Mitrovicës dhe i njëjti është masakruar; Ajvaz Mehana, në shtëpinë e të cilit është vrarë vllau i tij kur është zënë i gjallë Ajet Gërguri; Veli Osmani, i cili ka qenë minator dhe ka udhëhequr grevat e minatorëve, babai i Xhemajl Pllanës, i cili ka luftuar në Likoc deri në vrasjen e Shaban Polluzhës; Sabri Pllana, i cili është likuiduar. Po ashtu tha se ka një komplikim në mes të Dubocit dhe Ashlanit, pasi që emrat janë përzier dhe te emri i Fatmir Sejdiut, pyeti a është fjala për ish-presidentin e Kosovës dhe kush e ka propozuar. Në fund kërkoi që të vlerësohet drejtë kontributi i tërë atyre që kanë shërbyer për shtetin e Kosovës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- lidhur me propozim-listën tha se komisioni në fjalë ka realizuar diskutime publike gati në çdo fshat dhe lagje të qytetit, duke shtuar se ka qenë e pamundur që të gjithë emrat e personaliteteve të ndryshme të vendosen vetëm në qytet, prandaj kjo propozim-listë ka ardhur si rezultat i konsultimeve dhe propozimeve të paraqitura nga qytetarët e lagjeve dhe të fshatrave të Komunës së Vushtrrisë.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- paraqiti sqarime shtesë lidhur me propozim-listën në fjalë.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se nga Pestova ka ardhur një listë me propozime e cila rrugës është ndryshuar me disa emra dhe në KPF nuk ka ardhur e njëjta listë që është propozuar në këshillin e fshatit dhe një veprim i tillë është i kundërligjshëm.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- lidhur me diskutimin e R.Ramajt, tha se mbledhja e parë është shtyrë, kurse mbledhja tjetër të cilën e ka cilësuar të jashtëligjshme, sepse anëtari i komisionit nga radhët e LDK-së i ka hedhur në votim rrugët të cilat nuk është dashur t'i hedh në votim, dhe shtoi se propozimi ka ardhur

në komision dhe iu është ndërruar emri, ku konform ligjit rruga kryesore është emëruar Hysni Bunjaku.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-listës, kërkoi që të mos aprovohet lista me nxitim, por duhet të dalë një listë përfundimtare me sa më pak vërejtjeje dhe kjo ndodh kur jepet mundësia për marrjen e sugjerimeve dhe vërejtjeve dashamirëse. Në fund propozoi që të përfshihen edhe këta emra në listën për emërtimin e rrugëve: Faik Bala, i cili ka qenë një veprimtar që ka dhënë shumë kontribut të jashtëzakonshëm jo vetëm në Kosovë por edhe gjatë qëndrimit në mërgim; Galip Badivuku, i cili ka qenë një ekonomist i suksesshëm dhe ka udhëhequr me sukses ndërmarrjen ndërtimore "Kosova"; Lutfi Mustafa, i cili ka qenë një veprimtar i dalluar.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në me 21 vota "për", 7 "kundër" dhe 2 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim aprovohet lista e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Me këtë vendim bëhet kompensimi për anëtarët e komisionit për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Komisioni për emërtimin e rrugëve dhe shesheve për punën e tij kompensohet prej mallrave dhe shërbimeve nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Shuma e kompensimit për çdo anëtar të komisionit është 300 € (treqind euro), kurse totali i kompensimit për të gjithë anëtarët e komisionit është 7.500 € (shtatë mijë e pesëqind euro).

13. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të banesave përballë kalasë.

Milazim Hyseni, përfaqësues i banorëve të banesave- tha se së gjitha familjet e strehuara aty janë familje që nuk kanë pas mundësi të zgjedhin çështjen e strehimit dhe këto familje janë kategori sociale, familje të dëshmorëve, martirëve dhe familje të punëtorëve të arsimit, prandaj kërkoi nga institucionet e shtetit që të kenë parasysh gjendjen e këtyre familjeve dhe t'u japin atyre të drejtën e privatizimit të banesave në fjalë, pasi që i shfrytëzojnë qe 14 vite dhe të njëjtat i kanë meremetuar me vetfinancim. Në fund akuzoi të gjitha qeveritë komunale, dhe shtoi se nuk kanë bërë asgjë për zgjidhjen e problemit për familjet e strehuara në këto banesa.

Habib Mustafa, kryesues i kuvendit- tha se kuvendi i komunës nuk është fajtor për gjendjen e krijuar me këta banorë.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore- duke iu referuar kërkesës në fjalë dhe shqetësimit të qytetarëve të këtyre banesave, tha se një delegacion i lartë nga Komuna e Vushtrrisë është takuar me zyrtarët e Agjencionit Kosovar të Pronës dhe Agjencionin Kosovar të Privatizimit, të cilët menaxhojnë dhe administrojnë banesat në fjalë, dhe shtoi se në ndërmarrje shoqërore menaxhon dhe administron Agjencioni Kosovar i Pronës, të cilët janë të obliguar që lokalet në fjalë t'ia dorëzojnë të lira Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Po ashtu tha se qëndrimi i menaxherit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit ishte se do të jenë fleksibil sidomos për kategoritë që janë raste sociale, familje të dëshmorëve dhe familjet e martirëve, kurse për kategoritë tjera do të vlejné kriteret e tregut.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar kërkesës në fjalë, tha se edhe më parë Komuna e Vushtrrisë përmes ish-avokatit publik të komunës ka kërkuar që banesat bë fjalë t'i kthehen menaxhimit nga komuna, por institucionet e UNMIK-ut kanë vendosur që këto banesa të mbesin nën menaxhimin e Habitatit. Pastaj tha se situata aktuale për familjet në këto banesa është shqetësuese, sidomos për kategorinë e rasteve sociale, të atyre me familjarë të zhdukur, prandaj kërkoi që

agjencioni kompetent të ndërmerr të gjitha masat e mundshme ligjore dhe po ashtu kërkoi që kuvendi i komunës të merr një qëndrim për t'u vepruar në mënyrë të organizuar te institucionet përkatëse për gjetjen e zgjidhjes për këta banorë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- tha se Grupi kuvendar i PDK-së mbështet kërkesat e banorëve të banesave në fjalë, duke kërkuar që kuvendi i komunës të dalë me një deklaratë mbështetëse dhe të ndërmerren hapat e mëtutjeshëm për t'ua zgjidhur problemet e tyre.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- shprehu keqardhjen për situatën e krijuar për banorët e banesave në fjalë, pasi që ky problem është i vjetër dhe është trajtuar edhe në media, por këtë gjendje për këta banorë të banesave nuk e ka krijuar kuvendi i komunës. Pastaj tha se një bashkërendim me kohë në mes të autoriteteve komunale dhe AKP-së do ta zgjidhte këtë problem, dhe shtoi në këto banesa ka familje që kanë kontribuar, vuajtur dhe përjetuar gjëra të ndryshme, prandaj kërkoi që të shikohen të gjitha mundësitë ligjore në mënyrë që t'ju ofrohet një zgjidhje familjeve që banojnë në banesat në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi këtë:

DEKLARATË

Kuvendi i Komunës në Vushtrri përmes kësaj deklaratë shpreh mbështetjen e plotë për banorët të cilët jetojnë në kompleksin banesor përballë <kalasë> dhe inkurajon Agjencinë Kosovare të Privatizimit që të ketë qasje të drejtë gjatë procesit të privatizimit të këtyre banesave.

Kuvendi i Komunës i rekomandon Agjencisë Kosovare të Privatizimit që në ofertën e privatizimit të këtij kompleksi përparësi t'u jep banorëve të cilët kanë banuar në këto banesa që nga përfundimi i luftës, pasi që të njëjtit me investime vetanake i kanë meremetuar këto banesa.

Kuvendi i Komunës në Vushtrri e inkurajon Agjencinë Kosovare të Privatizimit që lidhur me këtë çështje të analizoi gjendjen për çdo rast veç e veç të banorëve të këtyre banesave, dhe në procesin e privatizimit prioritet t'u jepet familjeve me gjendje të rëndë sociale, e të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

b. Shqyrtimi i propozimeve për plotësimin e numrit të anëtarëve të KPF-së.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të PDK-së propozoi Selim Rrustemin për anëtar të KPF-së.

Remzije Isufi, anëtare e kuvendit- në emër të AKR-së propozoi Nasuf Aliun për anëtar të KPF-së.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim emërohen anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-së) në Vushtrri:

Selim Rrustemi (PDK);

Nasuf Aliu (AKR).

c. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- paraqiti një shqetësim dhe kërkesë të banorëve rreth lumit "Podrança", pasi që të jetosh në atë pjesë urbane dhe të mos guxosh t'i hapësh dritaret e shtëpisë për shkak të gjarpërinjve dhe kundërmimit është e rëndë, prandaj është e nevojshme që të krijohet një komision nga institucionet kompetente dhe komunale për ta përmirësuar gjendjen.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- kërkoi një listë të investimeve kapitale sipas vendbanimeve.


Besim Jashari, anëtar i kuvendit- kërkoi nga kryetari i komunës dhe ekzekutivi i komunës që të japin informatë lidhur me problemin tepër shqetësues që është largimi i të rinjve nga Kosova, pasi që në rastin e kaluar në lumin "Tisa" ka pas të mbytur nga Komuna e Vushtrrisë, prandaj kërkoi që të informohet cila është gjendja e të shpërngulurve nga Komuna e Vushtrrisë. Pastaj paraqiti shqetësimin për të ashtuquajturit "policë të shtrirë" nëpër rrugë, ku në shumë raste qytetarët në bazë të vlerësimit të tyre po e marrin përsipër vendosjen e tyre, por një gjë të tillë duhet ta vlerësojnë dhe t'i vendosin "policët e shtrirë" në mënyrë profesionale zyrtarët përgjegjës për komunikacion nga Komuna e Vushtrrisë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- për mbledhjen e ardhshme të KK-së kërkoi nga kryetari i komunës që t'i silltet një listë me emra dhe mbiemra për secilin kryetar të fshatit.

Sabri Ferati, anëtar i kuvendit- duke iu referuar qytetarëve të cilët dëshirojnë të diskutojnë në mbledhje të KK-së, kërkoi nga kryesuesi i kuvendit të mos i jepet e drejta e diskutimit secilit, si dhe t'ju kufizohet koha e diskutimeve, duke shtuar se diskutimi i përfaqësuesit të banesave përballë kalasë ka qenë tepër i vrazhdë dhe nënçmues.

Mbledhja përfundoi në orën 16:35.

Procesmbajtësi



Alban Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa